



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 222

---

Tiranë – E premte, 18 dhjetor 2020

---

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 126/2020, datë 15.10.2020	Për metrologjinë..... 17273



**LIGJ**  
**Nr. 126/2020**

**PËR METROLOGJINË<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka si qëllim të sigurojë:

- a) përdorimin e njërive matëse në përputhje me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive;
- b) gjurmueshmërinë e standardeve të matjes së Republikës së Shqipërisë ndaj standardeve

ndërkombëtare dhe standardeve kombëtare të vendeve të tjera;

c) matje uniforme në Republikën e Shqipërisë dhe besim në rezultatet e matjeve të kryera në funksion të tregut;

ç) lëvizjen e lirë të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, të cilat janë objekt i markimit CE, dhe markimin metrologjik;

d) lëvizjen e lirë të produkteve të parapaketuara nëse ato kanë shenjen e konformitetit dhe harmonizimin e metodave për matjet dhe kontrollin metrologjik;

dh) mbështetjen dhe zhvillimin e infrastrukturës së përshtatshme metrologjike, që të sigurojë gjurmueshmërinë e rezultateve të matjes;

e) drejtësinë dhe financimin e aktiviteteve të kërkimit dhe zhvillimit në metrologji;

ë) komunikimin e shpejtë, të saktë dhe lehtësisht të kuptueshëm dhe shkëmbim informacioni për çështjet metrologjike;

f) mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve të instrumenteve matëse.

**Neni 2**  
**Objekti**

Objekti i këtij ligji është të rregullojë sistemin e njësive së matjes, standardet e matjes, bazat për të siguruar gjurmueshmërinë e matjes, kontrollin metrologjik ligjor të instrumenteve matëse dhe rregullat për organizimin e funksionimit të sistemit kombëtar metrologjik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Për qëllime të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. “Instrument matës” është çfarëdo pajisje që përdoret për të bërë matje vetë, me një ose disa pajisje shtesë.

2. “Metrologji” është shkenca e matjeve dhe aplikimi i saj.

3. “Metrologji shkencore” është ajo pjesë e metrologjisë, e cila merret me realizimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e etaloneve kombëtare të matjeve. Metrologjia shkencore ka të bëjë me krijimin e njësive të matjes, zhvillimin e metodave të reja të matjes, realizimin e standardeve matëse

<sup>1</sup> Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

- Direktivën 2009/34/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009, në lidhje me dispozitat e përbashkëta për instrumentet matëse dhe për metodat e kontrollit metrologjik, e ndryshuar. Numri CELEX 32009L0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 106, datë 28.4.2009, f. 7–24.

- Direktivën 2007/45/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 shtator 2007, “Mbi përcaktimin e rregullave për sasitë nominale për produktet e parapaketuara, që shfuqizon direktivat e Këshillit 75/106/KEE dhe 80/232/KEE, dhe ndryshon Direktivën e Këshillit 76/211/KEE”. Numri CELEX 32007L0045, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 247, datë 21.9.2007, f. 17–20.

- Direktivën e Këshillit 75/107/KEE, datë 19 dhjetor 1974, “Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me shishet që përdoren si enë matëse”. Numri CELEX 31975L0107, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 42, datë 15.2.1975, f. 14–20.

- Direktivën 2014/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me vënien në dispozicion në treg të instrumenteve joautomatike të peshimit”. Numri CELEX 32014L0031, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 96, datë 29.3.2014, f. 107–148.

- Direktivën e Këshillit 76/211/KEE, datë 20 janar 1976, “Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me përbërjen sipas peshës ose volumit të produkteve të caktuara të parapaketuara”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31976L0211, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 46, datë 21.2.1976, f. 1–11.



dhe gjurmueshmërinë nga këto standarde të përdoruesit në një shoqëri.

4. “Metrologji industriale” është ajo pjesë e metrologjisë, që ka të bëjë me aplikimin e matjes në prodhim e procese të tjera dhe përdorimin e saj në shoqëri, duke siguruar përshtatshmërinë e instrumenteve matëse, kalibrimin e tyre dhe kontrollin e cilësisë.

5. “Metrologji ligjore” është ajo pjesë e metrologjisë, e cila rregullohet me ligj dhe dispozita të tjera normative për sigurimin e saktësisë dhe të besueshmërisë në rezultatet e matjes në fusha ku aplikohen instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara.

6. “Matje” është procesi i marrjes në mënyrë eksperimentale të një ose disa vlerave të një madhësie, që në mënyrë të arsyeshme mund t'i atribuohen kësaj madhësie.

7. “Njësi matjeje” është sasia reale shkallore e përcaktuar dhe e miratuar nga Konventa e Metrit, me të cilën mund të krahasohet çdo lloj madhësie tjetër e të njëjtit lloj për të shprehur raportin e dy sasive si një numër.

8. “Tipi i instrumentit matës” është modeli përfundimtar i një instrumenti matës ose moduli (përfshirë këtu një familje me instrumente ose module) për të cilin janë përkufizuar në mënyrë të përshtatshme të gjitha elementet që ndikojnë në karakteristikat e tij metrologjike.

9. “Etalon matjeje” është realizimi i përkufizimit të një madhësie të caktuar me vlerën e shprehur të sasisë dhe pasigurinë shoqëruese të matjes, e përdorur si referencë.

10. “Etalon kombëtar i matjeve” është instrument matjeje i miratuar nga Këshilli i Ministrave për të shërbyer në Republikën e Shqipërisë si një bazë për përcaktimin e vlerave të standardeve të tjera të matjes për madhësinë në fjalë.

11. “Etalon referues” është instrument matës i caktuar për kalibrimin e etaloneve të tjera matëse, për sasi të një lloji të caktuar në një organizatë ose vendndodhje të caktuar.

12. “Ruajtje e etalonit të matjes” përfshin të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur karakteristikat metrologjike të etalonit të matjes brenda kufijve të caktuar.

13. “Material referues” është një material njaftueshmërisht homogjen dhe i qëndrueshëm në lidhje me karakteristikat e specifikuar, i cili është

krijuar për të qenë i përshtatshëm për përdorimin e synuar në matje ose në ekzaminimin e karakteristikave nominale.

14. “Material referues i certifikuar” është një material referues, i shoqëruar me dokumentacionin e lëshuar nga organizma ndërkombëtarë apo kombëtarë dhe që jep një ose më shumë vlera të karakteristikës së specifikuar me pasiguritë dhe gjurmueshmëritë shoqëruese duke përdorur procedura të vlefshme.

15. “Gjurmueshmëri metrologjike” është cilësia e rezultatit të matjes ose vlera e etalonit të matjes, e arritur nëpërmjet një zinxhiri të pashkëputur të dokumentuar kalibrimesh, ku secili kontribuon në pasigurinë e matjeve.

16. “Kalibrim” është veprimtaria që në kushte të caktuara, së pari, krijon një marrëdhënie ndërmjet vlerave të madhësisë me pasigurinë e matjes, mundësuar kjo nga etalonet e matjes dhe indikacionet korresponduese të shoqëruara me pasigurinë e matjes dhe, së dyti, e përdor këtë informacion për të krijuar një lidhje për marrjen e një rezultati matjeje nga një tregim i caktuar.

17. “Instrument matës ligjërisht i kontrolluar” është një instrument matës, i cili është në përputhje me kërkesat e veçanta të metrologjisë ligjore.

18. “Verifikim i një instrumenti matës” është procedura e vlerësimit të konformitetit (ndryshe nga vlerësimi i tipit), e cila rezulton në vendosjen e shenjës së verifikimit dhe/ose lëshimin e certifikatës së verifikimit.

19. “Verifikim fillestar i instrumentit matës” është verifikimi i një instrumenti matës që nuk është verifikuar më parë.

20. “Verifikim pasardhës” është verifikimi i instrumentit matës pas një verifikimi të mëparshëm.

21. “Verifikimi periodik i detyrueshëm” është verifikimi i një instrumenti matës pas verifikimit të mëparshëm, që kryhet periodikisht, në intervale kohe të përcaktuara, në përputhje me këtë ligj dhe procedurat e vendosura nga aktet rregullatore përkatëse.

22. “Verifikim jashtë radhe i instrumentit matës” është një verifikim i kryer pas rimodelimit, eliminimit të mosfunksionimeve ose defekteve të tjera teknike (riparim) apo i kryer jashtë periudhës së verifikimit.

23. “Ekspertiza metrologjike” është testim i jashtëzakonshëm dhe matje zyrtare e një



instrumenti matës në bazë të një vendimi gjykatë, kur rezulton e nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për shërbimet objekt i këtij ligji.

24. “Autorizim” është një nga format e dhënies së të drejtës për të kryer verifikim të instrumenteve matëse në sferën e detyrueshme subjekteve private, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

25. “Certifikim” është dokumenti, i cili lëshohet nga trupat e autorizuara në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për produktet, proceset, sistemet ose personat.

26. “Parapaketim” është kombinimi i një produkti dhe një paketimi individual me të cilin është parapaketuar. Një produkt është i parapaketuar kur ai vendoset në një paketim, të çfarëdo natyre qoftë, pa qenë blerësi prezent, dhe sasia e produktit që përmbahet në paketim ka një vlerë të paracaktuar dhe nuk mund të ndryshohet pa u hapur paketimi ose pa iu nënshtruar një modifikimi të perceptueshëm.

27. “Shishe si enë matëse” është çfarëdo kontejneri i bërë prej qelqi ose prej ndonjë materiali tjetër, që ka një fortësi dhe qëndrueshmëri të tillë për të ofruar të njëjtat garanci metrologjike si qelqi, i taposur apo i projektuar për t’u taposur, që destinohet për magazinim, transport ose shpërndarje të lëngjeve e që ka karakteristika metrologjike (karakteristika të projektimit dhe uniformitetet të prodhuesit) të tilla që mund të përdoren si shishe matëse kur ato mbushen deri në një nivel specifik ose një përqindje të specifikuar të kapacitetit të tyre deri në buzë dhe përmbajtja e tyre mund të matet me një saktësi të mjaftueshme e që ka kapacitet nominal nga 0,05 deri në 5 litra.

28. “Inspektimi metrologjik” është procesi i ekzaminimit të një produkti apo procesi dhe përcaktimi i përputhshmërisë së tij me kërkesat specifike ose, sipas gjykimit profesional, me kërkesat e përgjithshme.

29. “Matje zyrtare” është çdo matje e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga persona juridikë privatë të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Matja zyrtare përdoret si evidencë e besueshme në procedurat dhe vendimmarrjet e organizmave qeveritarë apo të gjykatave.

30. “Miratim i tipit të instrumenteve matëse” është vendim i bazuar në raportin e vlerësimit të tipit, nëse tipi i një instrumenti matës përputhet me

kërkesat përkatëse ligjore, i cili konkludohet me lëshimin e certifikatës së miratimit të tipit.

31. “Vendosja në treg” është vënia për herë të parë në treg e një instrumenti matës ose një parapaketimi.

32. “Paketues” është çdo person fizik ose juridik i regjistruar në Shqipëri, përgjegjës për paketimin.

33. “Etalon sekondar” është instrument matës i siguruar nëpërmjet kalibrimit.

34. “Regjimi automatik” përfaqëson sigurimin dhe certifikimin metrologjik të tërësisë së kushteve në të cilat kryhet transferimi automatik i rezultateve të siguruar nga një instrument matës ligjërish i kontrolluar.

Neni 4

#### **Vënia në dispozicion e rezultateve të matjeve**

Rezultatet e matjeve, të kryera me kërkesë të organizmave qeveritarë ose që u shërbejnë nevojave të institucioneve shtetërore në Republikën e Shqipërisë dhe që kanë lidhje me transaksionet zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit, vihen në dispozicion të personave juridikë dhe fizikë kërkues, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.

KREU II

#### **ORGANIZIMI I SISTEMIT KOMBËTAR TË METROLOGJISË**

Neni 5

#### **Sistemi kombëtar i metrologjisë**

Sistemi kombëtar i metrologjisë përbëhet nga:

- a) ministria përgjegjëse për ekonominë;
- b) institucioni kombëtar shtetëror për metrologjinë/Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;
- c) laboratorët e autorizuar si mbajtës të etaloneve kombëtare dhe sekondare;
- ç) personat juridikë privatë të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të kryer shërbimet e parashikuara në këtë ligj;
- d) personat juridikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të kryer verifikim periodik të instrumenteve në metrologjinë ligjore, sipas dispozitave të këtij ligji;



dh) personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të kryer riparim të instrumenteve matëse;

e) inspektorati shtetëror që mbulon fushën e metrologjisë.

#### Neni 6

### **Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është person juridik publik, i specializuar për metrologjinë, në varësi të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

2. Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për ekonominë.

3. Struktura organike e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë miratohet me urdhër të Kryeministrit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili është nëpunës civil. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë janë nëpunës civilë sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil. Për personelin mbështetës, marrëdhëniet rregullohen sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 7

### **Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e metrologjisë**

1. Inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë është organi shtetëror i ngarkuar me kryerjen e funksioneve të inspektimit metrologjik dhe mbikëqyrjes së tregut në zbatim të këtij ligji dhe akteve rregullatore të tjera në fuqi.

2. Organizimi dhe funksionimi i këtij inspektorati përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 8

### **Detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë**

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë ka këto detyra e kompetenca:

a) i propozon strategjinë e zhvillimit të metrologjisë ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe ndjek zbatimin e saj;

b) propozon akte ligjore dhe nënligjore për metrologjinë, të cilat ia paraqet ministrisë përgjegjëse për ekonominë;

c) zhvillon, ruan dhe mirëmban etalonet kombëtare të matjeve në laboratorët e saj, në përputhje me kërkesat, standardet dhe udhëzuesit e organizmave rajonale dhe ndërkombëtarë të fushës;

ç) kryen aktivitete kërkimi dhe zhvillimi për metrologjinë;

d) siguron gjurmueshmërinë metrologjike të njësitë e Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) të Matjeve ose të standardet e matjeve të shteteve anëtare të Konventës së Metrit;

dh) siguron gjurmueshmërinë metrologjike për laboratorët e tjerë;

e) organizon ose merr pjesë në krahasime laboratorike për të përcaktuar nivelin e ekuivalencës së etaloneve të matjeve;

ë) i propozon ministrisë përgjegjëse për ekonominë njohjen e laboratorëve si mbajtës të etaloneve kombëtare të matjeve kundrejt plotësimit të kërkesave të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji dhe jep mendim për aktet ligjore dhe nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë;

f) monitoron mbajtjen dhe ruajtjen e etaloneve kombëtare të matjeve, që mbahen nga laboratorët e autorizuar si mbajtës të etaloneve kombëtare të matjes;

g) kryen miratim tipi, verifikim fillestar dhe verifikim periodik të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, përveç rasteve kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi është autorizuar ofrimi i këtyre shërbimeve nga ana e personave juridikë privatë;

gj) kryen miratimin dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve dhe shisheve enë matëse me shenjë konformiteti;

h) autorizon dhe monitoron personat juridikë për verifikimin e instrumenteve matëse, bazuar në kërkesat e përshkruara, përveç rasteve kur këto shërbime u janë dhënë personave juridikë privatë me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi;

i) autorizon dhe monitoron personat fizikë apo juridikë për riparimin e instrumenteve matëse;



j) krijon dhe mirëmban regjistrin e instrumenteve matëse, subjekt i kontrollit ligjor, përveç rasteve kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi është autorizuar ofrimi i këtyre shërbimeve nga ana e personave juridikë privatë;

k) bashkërendon punën me organizmat e tjerë të sistemit kombëtar të metrologjisë dhe mbështet zhvillimin e këtij sistemi kombëtar, si dhe bashkëpunon me institucionet e tjera, veçanërisht me ato të infrastrukturës kombëtare të cilësisë (standardizim dhe akreditim), të inspektimit dhe mbikëqyrjes së tregut të instrumenteve matëse dhe parapaketimeve;

l) shërben si referencë kombëtare për sistemin kombëtar të akreditimit të laboratorëve të kalibrimit, për aftësitë dhe etalonet e matjeve;

ll) përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë të metrologjisë, kryen detyrat që rrjedhin nga anëtarësimi në këta organizma dhe vendos bashkëpunim në fushën e metrologjisë;

m) bashkëpunon me organizmat kombëtarë të metrologjisë së vendeve të tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë në veprimtarinë e fushës përkatëse, rajonale apo ndërkombëtare, ose për të arritur marrëveshje dypalëshe;

n) ofron trajnime për aktivitete në fushën e metrologjisë.

#### Neni 9

### Detyrat dhe kompetencat e inspektoratit

Inspektorati shtetëror që mbulon fushën e metrologjisë, krahas kompetencave që përcaktohen në dispozitat e tjera të këtij ligji, kryen detyrat dhe kompetencat si më poshtë:

a) mbikëqyrjen e tregut të instrumenteve matëse të prodhuara/importuara dhe në përdorim;

b) inspektimin metrologjik të instrumenteve matëse dhe të produkteve të parapaktuara, gjithmonë kur është e zbatueshme dhe duke respektuar përjashtimet përkatëse në ligj, kontrata apo instrumente të tjera të barasvlershme me fuqinë juridike të ligjit për kryerjen e këtyre aktiviteteve;

c) merr vendim për heqjen nga tregu të instrumentit matës, parapaketimeve dhe shisheve si enë matëse kur nga inspektimi metrologjik në

aspektin fizik, dokumentar dhe laboratorik, gjithmonë kur është e zbatueshme dhe duke respektuar përjashtimet përkatëse sipas përcaktimeve në ligj, kontrata apo instrumentet e tjera të barasvlershme me fuqinë juridike të ligjit, rezulton që ky instrument, parapaketim apo shishe si enë matëse nuk është në konformitet dhe nuk plotëson kërkesat teknike metrologjike të kërkuara;

ç) kryen detyrat e përcaktuara në nenin 48 të këtij ligji, duke respektuar përjashtimet përkatëse, në kuadër të përmbushjes së funksionit të inspektimit, sipas përcaktimit të këtij ligji.

#### Neni 10

### Këshilli i metrologjisë

1. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë krijohet dhe funksionon Këshilli i Metrologjisë, i cili është organ këshillimor i drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

2. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Metrologjisë, si dhe mënyra e shpërblimit të anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për metrologjinë.

#### KREU III

### NJËSITË E MATJES

#### Neni 11

### Njësitë e matjes

1. Në Republikën e Shqipërisë do të përdoren si njësi matjeje:

a) njësitë e Sistemit Ndërkombëtar të Njësive të Matjes (SI), duke përfshirë shumëfishat dhe nënfishat e tyre;

b) njësitë e matjeve jashtë sistemit SI, që përdoren për transportin ajror, detar dhe hekurudhor, të miratuara me konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) që do të përdoren në Shqipëri, njësitë që rrjedhin prej tyre, shumëfishat dhe nënfishat, njësitë shtesë të vendosura ndërkombëtarisht dhe mënyra e përdorimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



KREU IV  
STANDARDET MATËSE

PJESA E PARË  
METROLOGJIA SHKENCORE

Neni 12  
**Etalonet kombëtare të matjeve**

1. Etalonet e matjes përcaktojnë, riprodhojnë, realizojnë dhe ruajnë njësitë e matjes.

2. Etalonet e matjeve, që zotërojnë saktësinë e nevojshme dhe që kanë një shkallë të kënaqshme të ekuivalencës me etalonet ndërkombëtare të matjeve, do të njihen si etalone kombëtare të matjeve.

3. Etalonet kombëtare të matjeve do të përdoren si bazë për vlerë reference të standardet e tjera të matjes të njësisë matëse përkatëse.

4. Ministria përgjegjëse për ekonominë miraton planin afatgjatë për zhvillimin e etaloneve kombëtare të matjeve, bazuar në nevojat e vendit.

5. Kërkesat dhe kushtet që duhet të plotësojë një standard matjeje për t'u deklaruar etalon kombëtar matjeje në një fushë të caktuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13  
**Laboratorët e etaloneve kombëtare të matjeve**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë në laboratorët e saj zhvillon, ruan dhe mirëmban etalonet kombëtare të matjeve.

2. Aftësia/kompetenca teknike e laboratorëve të etaloneve kombëtare të matjeve provohet nëpërmjet vetëdeklarimit të kapaciteteve matëse dhe kalibruese, sipas marrëveshjes së njohjes së ndërsjellë të Komitetit Ndërkombëtar të Peshave dhe Masave ose akreditimit.

3. Institucionet publike që zotërojnë standarde matjeje, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, kanë të drejtë të aplikojnë për deklarimin dhe njohjen e këtij standardi si etalon kombëtar matjeje.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë bashkërendon veprimtaritë e laboratorëve mbajtës të etaloneve kombëtare dhe mban regjistrin e etaloneve kombëtare të matjeve.

5. Zhvillimi, mirëmbajtja, përmirësimi dhe aktivitetet që lidhen me etalonet kombëtare të matjeve financohen nga buxheti i shtetit.

Neni 14  
**Detyrat e laboratorëve mbajtës të etaloneve kombëtare të matjeve**

Laboratorët mbajtës të etaloneve kombëtare kryejnë detyrat si më poshtë:

a) sigurojnë gjurmueshmërinë e etaloneve kombëtare të matjeve deri tek etalonet ndërkombëtare të matjeve ose tek etalonet kombëtare të shteteve anëtare të Konventës së Metrit;

b) organizojnë dhe/ose marrin pjesë në krahasime laboratorike, rajonale dhe ndërkombëtare, për të përcaktuar nivelin e ekuivalencës së etaloneve kombëtare të matjeve;

c) transmetojnë njësitë e etaloneve kombëtare të matjeve tek etalonet referuese të matjeve dhe të instrumenteve matëse me anë të kalibrimit ose të përdorimit të materialeve referuese të certifikuar sipas procedurave të përshkruara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;

ç) sigurojnë vlerat referuese të njësisë përkatëse të matjeve për krahasimet ndërlaboratorike të organizuara për laboratorët e kalibrimit;

d) zbatojnë dhe mirëmbajnë sistemin e menaxhimit të cilësisë në përputhje me kërkesat e organizmave evropianë dhe ndërkombëtarë të metrologjisë.

dh) sigurojnë njohjen ndërkombëtare të etaloneve kombëtare të matjeve nëpërmjet vetëdeklarimit të kapaciteteve matëse dhe kalibruese në Byronë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (BIPM), si dhe në bazën e të dhënave për krahasimin e testeve (KCDB);

e) ndërmarrin masa për sigurimin e gjurmueshmërisë në rastin e dëmtimit dhe të shkatërrimit të etaloneve kombëtare të matjeve.

PJESA E DYTË  
METROLOGJIA INDUSTRIALE

Neni 15  
**Gjurmueshmëria e njësisë të matjeve**

Transmetimi i njësisë të matjeve tek instrumentet matëse sigurohet me anë të kalibrimit ose nëpërmjet përdorimit të materialeve referuese



të certifikuara. Në rastet kur shërbimet, objekt i këtij ligji, kryhen nga subjekte të autorizuar me një nga format e parashikuara në ligj, gjurmueshmëria realizohet vetëm nga këto subjekte.

Neni 16

### **Kalibrimi i etaloneve të matjes dhe të instrumenteve matëse**

1. Kalibrimi kryhet në përputhje me udhëzimet dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare për standardizimin, akreditimin dhe metrologjinë.

2. Kalibrimi i etaloneve të matjeve dhe i instrumenteve matëse kryhet në laboratorët e kalibrimit me kërkesën e përdoruesit.

KREU V

## **METROLOGJIA LIGJORE**

PJESA E PARË

Neni 17

### **Instrumentet matëse ligjorisht të kontrolluara**

1. Sipas këtij ligji, instrumentet matëse ligjorisht të kontrolluara janë instrumentet matëse që përdoren në:

a) transaksionet tregtare dhe zyrtare për arsye të interesit publik, për sigurinë dhe rendin, mbrojtjen e konsumatorit dhe mjedisit, për mbledhjen e taksave dhe detyrimeve dhe tregtisë së ndershme;

b) kontrollin e produkteve të parapaketuara dhe shisheve si enë matëse;

c) matjet e përshkruara nga ky ligj dhe rregulla të përshtatura për zbatimin e tyre,

të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve.

2. Aktivitetet që janë të ndërlidhura me mjetet matëse, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë subjekt i kontrollit ligjor sipas dispozitave të këtij ligji, çdo kontrate, me anë të së cilës shërbimi i kontrollit ligjor kryhet nga persona juridikë privatë të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, dhe akteve rregullatore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

3. Instrumentet matëse ligjorisht të kontrolluara, që nuk janë objekt i markimit CE, ashtu si dhe përbërësit e tyre, pajisjet shtesë dhe pajisjet ndihmëse, i nënshtrohen kontrollit metrologjik, që

kryhet nëpërmjet miratimit të tipit, verifikimit fillestar, verifikimit pasardhës dhe verifikimit jashtë radhe, kur lind nevoja, të instrumenteve matëse.

4. Përjashtimisht nga pika 3 e këtij neni, instrumentet matëse objekt të markimit CE, markimit suplementar të shoqëruar me dy numrat e fundit të vitit të prodhimit, numri identifikues i trupës notifikuese, që është përfshirë në vlerësimin e konformitetit, nuk i nënshtrohen miratimit të tipit dhe verifikimit fillestar, por vetëm verifikimeve pasardhëse dhe verifikimeve jashtë radhe kur lind nevoja.

5. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për kërkesat teknike dhe metrologjike, si dhe rregullat teknike për instrumentet matëse ligjorisht të kontrolluara sipas pikës 3, me propozim të ministrit përgjegjës për metrologjinë.

Neni 18

### **Vendosja në treg dhe/ose vënia në përdorim e instrumenteve matëse ligjorisht të kontrolluara**

1. Instrumentet matëse, që janë objekt i markimit CE, vendosen në treg dhe/ose vihen në përdorim nëse kanë markimin CE, Markimin Metrologjik Suplementar M dhe dy shifrat e fundit të vitit të prodhimit të rrethuara nga një drejtkëndësh, lartësia e të cilit është e njëjtë me lartësinë e markimit CE; numrin unik të trupës notifikuese që ka marrë pjesë në fazën e kontrollit të prodhimit, i cili vendoset nga vetë trupa ose, sipas udhëzimeve të tij, nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, nëpërmjet së cilës prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi garanton se instrumenti matës është në përputhje me kërkesat metrologjike të përshkruara.

2. Instrumentet matëse ligjorisht të kontrolluara, që nuk janë objekt i markimit CE, mund të vendosen në treg dhe/ose të vihen në përdorim vetëm nëse janë verifikuar sipas një procedure të përshkruar në këtë ligj, si rezultat i së cilës është realizuar miratimi i tipit dhe verifikimi fillestar i tij.

3. Instrumentet matëse ligjorisht të kontrolluara vendosen në treg dhe/ose vihen në përdorim vetëm nëse janë instrumente matëse inteligjente (*smart*).

4. Instrumentet matëse ligjorisht të kontrolluara jointeligjente lejohen të vendosen në treg deri më 1 janar 2023.





5. Instrumentet matëse ligjërish të kontrolluar jointeligjente lejohen të përdoren në treg deri më 31 dhjetor 2028.

6. Për arsye të interesit publik, për sigurinë dhe rendin, mbrojtjen e konsumatorit dhe mjedisit, për mbledhjen e taksave dhe detyrimeve dhe tregtisë së ndershme, Këshilli i Ministrave miraton listën e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara jointeligjente, që lejohen të vendosen në treg dhe/ose vihen në përdorim, si dhe afatin e vendosjes në treg dhe/ose përdorimit të tyre.

#### Neni 19

##### **Përdorimi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara**

1. Instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, që përdoren në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duhet të përputhen me tipin e miratuar dhe/ose kërkesat teknike dhe metrologjike, të jenë të verifikuara dhe të kenë të fiksuara shenjat e vlefshme të përshkruara.

2. Një instrument matës ligjërish i kontrolluar, që është në vendin e përdorimit, por që nuk është verifikuar, duhet të jetë i shënjuar në mënyrë të dukshme me shenjën “instrument matës jo në përdorim”. Instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, të përdorura në fushën e hidrokarbureve dhe të gazit të lëngshëm, nuk mund të qëndrojnë në këtë gjendje në vendin e përdorimit për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i vendosjes së shenjës dalluese “instrument matës jo në përdorim”.

3. Personat juridikë dhe fizikë gjatë ushtrimit të veprimtarisë duhet të përdorin instrumente matëse ligjërish të kontrolluara, të cilat i janë nënshtruar verifikimit metrologjik, në mënyrë që të sigurojnë saktësinë e kërkuar të matjeve. Ata janë përgjegjës për performancën teknike të instrumenteve matëse dhe për saktësinë e rezultateve të matjeve.

4. Ministri përgjegjës për metrologjinë, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, përshkruan shenjën dalluese “instrument matës jo në përdorim” të instrumenteve matëse që janë në vendin e përdorimit, por nuk janë verifikuar sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj, përveç rasteve kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi është autorizuar ofrimi i këtij shërbimi nga ana e personave juridikë privatë.

#### Neni 20

##### **Detyrimet e përdoruesve të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim**

Përdoruesi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara duhet:

- a) të përdorë instrumente matëse të verifikuara;
- b) të mirëmbajë instrumentet matëse në kushte teknike që sigurojnë saktësinë e matjeve;
- c) të verifikojë instrumentet matëse sipas këtij ligji, akteve rregullatore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe çdo kontrate me anë të së cilës autorizohet kryerja e këtij shërbimi;
- ç) të përdorë instrumentet matëse në përputhje me qëllimin e tyre;
- d) të mbajë regjistrime për mirëmbajtjen dhe verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim, sipas kërkesave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për metrologjinë.

#### Neni 21

##### **Miratimi i tipit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë miraton tipin e instrumentit matës në përputhje me rregulloren e ministrit, kur ai plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, të dala në zbatim të pikave 3 dhe 5 të nenit 17 të këtij ligji.

2. Dispozitat e këtij neni nuk aplikohen për instrumentet matëse objekt i markimit CE.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë merr vendim për refuzimin ose heqjen e miratimit të tipit të instrumentit matës kur ky instrument nuk plotëson më kërkesat teknike dhe metrologjike të kërkuara, të përcaktuara për një procedurë testimi.

4. Kundër vendimit për refuzimin ose për heqjen e miratimit të tipit të instrumentit matës mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njofimit.

5. Ministri përgjegjës për ekonominë miraton rregulloren për miratimin e tipit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara.



## Neni 22

**Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara**

1. Të gjitha instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike, i nënshtrohen verifikimit që mund të jetë fillestar, pasardhës, periodik i rregullt, i kryer në intervale kohore specifike dhe jashtë radhe. Në varësi të analizës së riskut dhe problematikave të tregut, por në çdo rast jo më pak se 5%, periodiciteti i verifikimeve të lartpërmendura do të jetë të paktën objekt dyfishimi. Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike, bëhet jo më pak se dy herë në vit dhe përfshin kontrollin dhe sigurimin e regjimit automatik.

2. Me përjashtim të shërbimit të kontrollit ligjor, nëpërmjet verifikimit të të gjitha instrumenteve matëse, të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, kryerja e të cilit bëhet ekskluzivisht nga një person juridik privat, i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, shërbimet e tjera të verifikimit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, e cila mund t'ua delegojë këtë shërbim personave juridikë privatë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 39 të këtij ligji.

3. Në çdo rast, për shërbimin e verifikimit, subjektet e mësipërme duhet të lëshojnë certifikatën e verifikimit me kërkesë të aplikantit edhe nëse instrumenti matës ka të fiksuar shenjen e verifikimit.

4. Rastet kur verifikimi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara pengohet me çfarëdo lloji forme nga subjekti përdorues/pronar, do të konsiderohen shkelje të rënda të këtij ligji. Kur këto raste nuk përbëjnë vepër penale, subjekti përdorues/pronar i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara do të dënohet me pezullim të menjëhershëm të veprimtarisë tregtare plus gjobën përkatëse dhe çdo lloj mase tjetër administrative që mund të merret, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Këto masa do të merren menjëherë nga inspektorati, por në çdo rast jo më vonë se 7 ditë nga konstatimi i shkeljes ose marrja e informacionit për këtë shkelje nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose persona juridikë

privatë të autorizuar për të kryer verifikimet me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

5. Në rastet kur konstatohet se instrumentet matëse që janë vendosur në treg janë në kundërshtim me këtë ligj, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë apo personat juridikë privatë të autorizuar për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, informojnë inspektoratin dhe/ose autoritetet e tjera shtetërore përkatëse.

6. Ministri përgjegjës për ekonominë miraton rregulloren për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara në përputhje me këtë ligj dhe me çdo akt tjetër me fuqi të njëjtë me ligjin.

## Neni 23

**Mbarimi i vlefshmërisë së verifikimit**

Verifikimi i një instrumenti matës ligjërish të kontrolluar nuk është i vlefshëm kur:

- a) ka mbaruar periudha e verifikimit;
- b) instrumenti matës i nënshtrohet një modifikimi, që ndikon në karakteristikat e tij metrologjike;
- c) instrumenti matës është dëmtuar në mënyrë të tillë, që ka humbur disa nga karakteristikat e tij thelbësore teknike dhe metrologjike ose qëllimin e tij të përdorimit;
- ç) shenja e verifikimit është hequr, dëmtuar dhe/ose shkatërruar;
- d) instrumenti matës ka humbur karakteristikat metrologjike të përshkruara, megjithëse shenja e verifikimit nuk është dëmtuar dhe/ose shkatërruar;
- dh) kanë ndryshuar kushtet mjedisore, vendndodhja dhe kushtet e përdorimit të instrumentit matës.

## Neni 24

**Verifikimi fillestar i instrumentit matës ligjërish të kontrolluar, që nuk është objekt i markimit CE**

1. Instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, që janë me tip të miratuar, i nënshtrohen verifikimit fillestar, me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe.

2. Verifikimi fillestar i instrumentit matës ligjërish të kontrolluar është përgjegjësi e prodhuesit, përfaqësuesit të autorizuar, importuesit,



ose përdoruesit të instrumentit matës. Verifikimi fillestar konsiston në kontrollin e instrumentit matës të ri ose të riparuar dhe vërtetimin e përputhshmërisë së tij me tipin e miratuar. Pas kalimit me sukses të procedurës së verifikimit fillestar, instrumenti matës ligjërish i kontrolluar certifikohet me shenjë të verifikimit fillestar.

3. Kur instrumenti matës i nënshtrohet verifikimit fillestar, kontrolli duhet të përcaktojë nëse:

a) instrumenti matës është i tipit të miratuar dhe në përputhje me të;

b) instrumenti i përket një kategorie të përjashtuar nga tipi i miratuar dhe, në këtë rast, nëse përmbush kërkesat teknike dhe funksionale.

4. Instrumentet matëse të vendosura në treg, që kanë miratim tipi, i nënshtrohen verifikimit fillestar përpara se të përdoren.

#### Neni 25

### Verifikimi pasardhës i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara

1. Verifikimi pasardhës i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara përfshin verifikimin periodik të rregullt dhe verifikimin jashtë radhe, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Përgjegjës për sigurimin e verifikimeve pasardhëse të instrumentit matës ligjërish të kontrolluar, sikundër parashikohet në pikën 1 të këtij neni, është vetë përdoruesi i instrumentit.

3. Verifikimi periodik i rregullt i instrumenteve matëse bëhet sipas intervaleve të përcaktuara për tipa të ndryshëm instrumentesh matës në këtë ligj dhe/ose aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

4. Nuk kryhet verifikim periodik për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, të cilat nuk kanë verifikim fillestar.

5. Verifikimi periodik i instrumenteve matëse është përgjegjësi ligjore e përdoruesit/pronarit të tij.

6. Verifikim jashtë radhe i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara bëhet në rastet kur:

a) instrumenti nuk ka qenë në përdorim për shkak të defektit apo mangësive teknike;

b) është bërë riparimi;

c) në rastin kur instrumenti matës nuk i është nënshtrohet verifikimit periodik të rregullt në afatin kohor të parashikuar;

ç) ka një kërkesë për kryerjen e tij nga:

i. institucionet shtetërore përkatëse, që merren me mbikëqyrjen e tregut dhe instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara që gjenden në treg;

ii. subjekti juridik/pronari i instrumenteve matëse;

iii. përdoruesi i instrumenteve matëse;

iv. konsumatorët, të cilët konsiderojnë se janë dëmtuar nga instrumentet matëse ligjërish të kontrolluar;

v. personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e verifikimeve, sipas këtij ligji, kur vlerësohet e nevojshme prej tyre.

7. Verifikimi periodik i instrumenteve matëse, si: matësit e ujit të ngrohtë/të ftohtë, matësit e energjisë elektrike dhe të gazit janë përgjegjësi ligjore e personave juridikë/fizikë, që shesin ujin e ftohtë apo të ngrohtë, gazin dhe energjinë elektrike.

#### Neni 26

### Vendi i verifikimit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik, i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, kryen verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, në kushtet e veta dhe në vendet e verifikimit.

2. Vendi i verifikimit është vendi jashtë kushteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose të personit juridik privat të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, ku këto të fundit kryejnë verifikimin e një tipi të veçantë instrumenti matës ligjërish të kontrolluar duke përdorur pajisjet e përkrahura, që i përkasin kësaj drejtorie, personit juridik privat, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, ose përdoruesit të instrumentit matës.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose personi juridik privat, i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, kryen verifikimin e instrumentit matës ligjërish të kontrolluar në vendet ku janë vendosur, ndërfutur apo instaluar instrumentet matëse, në rastet kur një instrument matës ligjërish i kontrolluar, për shkak të konstruksionit, është i lidhur me vendin e instalimit, ose në raste të instrumenteve matëse që, për shkak të konstruksionit të tyre, mund të dëmtohen apo thyhen gjatë transportit.



4. Kur kryhet verifikimi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara sipas pikës 3 të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose personi juridik privat, i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, mund t'i kërkojë përdoruesit të instrumentit matës numrin e duhur të personelit ndihmës dhe të pajisjeve verifikuese.

#### Neni 27

##### **Shenjat e verifikimit**

1. Shenjat e verifikimit të përdorura në Republikën e Shqipërisë janë shenja shtetërore, përveç rasteve kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi është autorizuar ofrimi i këtyre shërbimeve nga ana e personave juridikë privatë. Në këtë rast, këto shenja kanë të njëjtat efekte si shenjat shtetërore.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përcakton tipin, formën dhe fiksimin e shenjave të përdorura për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës së verifikimit, me përjashtim të rasteve kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi është autorizuar ofrimi i këtyre shërbimeve nga ana e personave juridikë privatë. Në këto raste, përcaktimi i të gjitha të dhënave dhe shenjave të verifikimit, sikundër përmendet në këtë pikë, kryhet nga personi juridik privat, i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

#### Neni 28

##### **Përdorimi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara të riparuar**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të kryer shërbimin e verifikimit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, përcaktojnë periudhën kohore të përdorimit të instrumentit pas riparimit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, e cila në çdo rast nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i kryerjes së riparimit.

2. Sa herë që konstatohet nevoja për riparim, subjektet që përdorin instrumente matëse ligjërish

të kontrolluara duhet të njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë/subjekte të autorizuar prej saj për të kryer riparimin, si edhe personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të kryer verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, për nevojën e kryerjes së riparimit, duke e nxjerrë jashtë funksionimit instrumentin matës ligjërish të kontrolluar, nga momenti i njoftimit derisa të përfundojë procesi i riparimit.

3. Subjekti i autorizuar për të kryer veprimtari metrologjike riparimi, pas kryerjes së riparimit, duhet të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë ose personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, për kryerjen e riparimit dhe të përgatisë instrumentin matës ligjërish të kontrolluar për t'iu nënshtruar verifikimit pas riparimit nga ana e këtyre subjekteve, në mënyrë që brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh të kryhet verifikimi pas çdo riparimi të instrumenteve matëse dhe të vendoset shenja përkatëse e verifikimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë/subjektet e autorizuar prej saj për të kryer riparimin, si edhe te personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të kryer verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara.

#### Neni 29

##### **Etalonet e matjeve dhe materialet referuese në metrologjinë ligjore**

1. Për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara duhet të përdoren vetëm etalone matjeje të kalibruara, që kanë certifikatë kalibrimi të vlefshme dhe materiale referuese të certifikuara, që kanë certifikatë materiali referues të vlefshëm.

2. Drejtoria e Përgjithshme të Metrologjisë rekomandon intervalet e kalibrimit për etalonet e matjes, që përdoren për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, me përjashtim të rasteve kur intervalet e kalibrimit janë të përcaktuara në kontrata apo instrumente të tjera të parashikuara dhe rregulluara nga legjislacioni në fuqi.



Neni 30

### **Certifikatat dhe shenjat e konformitetit të instrumenteve matëse, të lëshuara jashtë vendit**

1. Republika e Shqipërisë njeh certifikatat dhe shenjat e konformitetit të lëshuara jashtë vendit nëse ato janë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë pranon raportet e testimit dhe të verifikimit nëse ato janë lëshuar sipas kërkesave të marrëveshjeve të pranimit reciprok të Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë mban bazë të dhënash të certifikatave, të shenjave të konformitetit, të lëshuara në përputhje me pikën 1 të këtij neni, në të cilën ka akses edhe inspektorati shtetëror që mbulon fushën e metrologjisë.

Neni 31

### **Verifikimi i sistemeve matëse**

1. Verifikimi periodik dhe jashtë radhe i sistemeve matëse përfshin verifikimin e një instrumenti matës ligjërish të kontrolluar si një pjesë përbërëse e sistemit, si dhe verifikimin e sistemit si i tërë.

2. Pjesët e sistemit, që nuk ndikojnë në performancën metrologjike të sistemit, përjashtohen nga kontrolli metrologjik ligjor.

3. Verifikimi i instrumentit matës ligjërish të kontrolluar, si pjesë e sistemit matës, dhe verifikimi i sistemit matës si i tërë janë përgjegjësi e përdoruesit/pronarit të sistemit matës.

Neni 32

### **Pajisje me funksione matëse**

Pajisjet me funksione matëse, që përdoren sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të nenit 2 të këtij ligji, që janë ekzaminuar, testuar dhe vlerësuar në përputhje me rregulla të tjera, janë subjekt i dispozitave të këtij ligji dhe i rregullave të nxjerra për zbatimin e tij.

Neni 33

### **Plumbosja**

1. Vetëm në rastet kur shërbimet, objekt i këtij ligji, kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, drejtori i Përgjithshëm i këtij

institucioni përcakton procedurat e plumbosjes për rastet kur në bazë të këtij ligji ose të ligjeve të tjera parashikohet detyrimi për plumbosje.

2. Në rastet kur shërbimet, objekt i këtij ligji, kryhen nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, procedurat e plumbosjes përcaktohen në kontratat përkatëse dhe/ose instrumentet e tjera pjesë përbërëse e tyre.

## **PJESA E DYTË**

### **EKSPERTIZA METROLOGJIKE**

Neni 34

### **Ekspertiza metrologjike e një instrumenti matës**

1. Ekspertiza metrologjike konsiston në testim të jashtëzakonshëm dhe matje zyrtare të një instrumenti matës në bazë të një vendimi gjykate, kur rezulton e nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për shërbimet, objekt i këtij ligji. Në rastet kur shërbimet, objekt i këtij ligji, kryhen nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, çdo ekspertizë metrologjike do të kryhet nga trupa ndërkombëtare të akredituar.

2. Kostot që dalin gjatë testimit të jashtëzakonshëm dhe matjeve zyrtare të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara do të paguhen nga:

a) pala kërkuese në rastin kur instrumenti ka shenjën e verifikimit të vlefshme dhe nga testimi i jashtëzakonshëm rezulton në përputhje me kërkesat metrologjike;

b) përdoruesi i instrumentit matës kur nga testimi i jashtëzakonshëm rezulton që instrumenti është jo në përputhje me kërkesat metrologjike.

## **PJESA E TRETË**

### **PARAPAKETIMET DHE SHISHET**

Neni 35

### **Parapaketimet e kontrolluara ligjërish**

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në parapaketimet njëshe, të kombinuara, pa ambalazh mbështjellës dhe në enë matëse që janë prodhuar, hedhur në treg ose ofruar për shitje te një blerës i panjohur.



2. Mostrat e lira, disa nga parapaketimet e destinuar, të përdorura në aeroplane, anije e trena, dhe produktet në kontejnerë, që janë përgatitur për konsumatorin e fundit në bazë të një kontrate të ndërsjellë, nuk vlerësohen parapaketime sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për parapaketimet, që përcakton:

- a) kriteret, parimet kryesore dhe masat e përgjithshme për parapaketimet;
- b) parapaketimet që kontrollohen ligjërisht;
- c) kërkesat metrologjike për sasinë neto të parapaketimeve;
- ç) diapazonet e detyrueshme për sasinë nominale të disa parapaketimeve;
- d) metodat referuese për kontrollin e sasisë neto të parapaketimeve;
- dh) mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në parapaketime.

Neni 36

#### **Shishet si enë matës ligjërisht të kontrolluara**

1. Shishet, si enë matëse, janë enë prej qelqi ose prej ndonjë materiali tjetër, që ruajnë formën e tyre të pandryshueshme në përputhje me kërkesat metrologjike të përshkruara, kapaciteti nominal i të cilave është nga 0,05–5 litra, përfshirë edhe këto dy vlera.

2. Shishet, si enë matëse, duhet të pajisen me shenja që tregojnë vëllimin nominal dhe atë të mbushjes deri në buzë, si dhe me shenjen që identifikon prodhuesin e enës matëse.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për shishet enëmatëse, që përcakton:

- a) shishet që kontrollohen ligjërisht;
- b) kërkesat metrologjike për shishet si enë matëse;
- c) metodat referuese për kontrollin e vëllimit neto të shisheve;
- ç) mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në shishet si enë matëse.

Neni 37

#### **Vendosja në treg e parapaketimeve dhe e shisheve si enë matëse**

1. Mallrat e paketuara dhe shishet si enëmatëse mund të hidhen në treg dhe të ofrohen për shitje vetëm nëse plotësojnë kërkesat metrologjike të

përshkruara, kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara deri në kohën e blerjes.

2. Paketuesi ose importuesi është përgjegjës për përputhshmërinë e produkteve të paketuara me masat e përcaktuara në këtë ligj.

3. Paketuesi zbaton sistemin e tij të kontrollit të sasisë neto të paketimeve.

4. Paketuesi ose importuesi, kur konstaton se parapaketimet e vendosura në treg prej tij nuk përmbushin kërkesat ligjore të përshkruara, është i detyruar që në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e metrologjisë të marrë masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit.

5. Prodhuesi ose importuesi është përgjegjës për përputhshmërinë e shisheve si enë matëse me masat e përcaktuara në këtë ligj.

6. Prodhuesi zbaton sistemin e kontrollit të vëllimit neto të shisheve të prodhuara.

7. Prodhuesi ose importuesi, kur konstaton se shishet si enë matëse të vendosura në treg prej tij nuk përmbushin kërkesat ligjore të përshkruara, është i detyruar që në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e metrologjisë të marrë masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 38

#### **Miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të paketuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë miraton sistemin e kontrollit sasior të paketuesit të parapaketimeve me shenjë konformiteti, që kanë bërë kërkesë për miratim sistemi, nëse ai plotëson kërkesat e përcaktuara.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë monitoron sistemin e kontrollit sasior të miratuar të paketuesit dhe, në qoftë se është e nevojshme, jep rekomandime për përmirësimin e tij.

3. Regjistrimi i paketuesit të parapaketimeve me shenjë konformiteti bëhet dhe ruhet si i tillë vetëm nëse sistemi i tij i kontrollit sasior është i miratuar.

4. Ministri përgjegjës për ekonominë përcakton rregullat dhe procedurat e miratimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të paketuesit të parapaketimeve me shenjë konformiteti.



PJESA E KATËRT  
DHËNIA E AUTORIZIMIT

Neni 39

**Autorizimi i personave juridikë dhe fizikë  
për të kryer veprimtari në metrologjinë ligjore**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë jep autorizimin në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, dhe për aq sa lejohet dhe mundësohet nga ligje, kontrata koncesionare dhe instrumente të tjera që kanë forcën zbatuese të ligjit.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë autorizon persona juridikë, që plotësojnë kushtet e përshkruara, për të realizuar verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, kur kjo drejtori nuk ka kapacitete teknike t'i realizojë vetë këto detyra dhe për sa është e lejueshme nga legjislacioni apo kontrata dhe instrumente të tjera në fuqi, që kanë forcën zbatuese të ligjit.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë autorizon persona juridikë apo fizikë për shërbimin e riparimit të instrumenteve matëse. Shërbimi i riparimit të instrumenteve matëse ndalohet të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e instrumenteve matëse.

4. Ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë të miratojë rregulloren për kriteret dhe procedurat për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse, si dhe për monitorimin e aktivitetit/performancës së tyre në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 40

**Vendimi për autorizim**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë vendos për dhënien e autorizimit brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga aplikimi.

2. Vendimi për autorizim përcakton qëllimin e autorizimit.

3. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 4-vjeçare.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë cakton shenjën verifikuese të një personi të autorizuar prej saj për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 41

**Monitorimi i subjekteve të autorizuar nga  
Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë**

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë monitoron aktivitetin e subjekteve të autorizuar prej saj për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e ministrit të miratuar për këtë qëllim, me përjashtim të rasteve kur funksionet monitoruese të performancës së personave juridikë privatë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore, u janë caktuar autoriteteve të tjera shtetërore me ligj ose kontratë të miratuar me ligj.

Neni 42

**Shfuqizimi i vendimit për autorizim**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mund të shfuqizojë vendimin e autorizimit kur:

a) nuk plotësohen kushtet për të cilat është dhënë autorizimi dhe nuk kryhen detyrat në mënyrën e kërkuar;

b) cenohen rëndë detyrimet e caktuara në këtë ligj dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij;

c) mbajtësit të autorizimit i kanë ndodhur ndryshime që e bëjnë të pamundur respektimin e kushteve për të cilat është dhënë autorizimi.

2. Personi juridik dhe fizik, autorizimi i të cilit është shfuqizuar, sepse ai ka vepruar kundër rregullave, në mënyrë joprofesionale, si dhe në kundërshtim me sa parashikohet në autorizim, nuk mund të aplikojë për një autorizim të ri brenda një periudhe prej 3 vjetësh nga data që i është shfuqizuar autorizimi.

3. Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtën e ankimit kundër shfuqizimit të vendimit për autorizim. Kundër shfuqizimit të vendimit për autorizim, personat juridikë apo fizikë, pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, në përputhje me Kodin e Procedurave Adminis-



trative mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 43

#### **Pavlefshmëria e autorizimit**

Autorizimi bëhet i pavlefshëm kur:

- a) mbaron afati i vlefshmërisë;
- b) drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ka nxjerrë vendim për anulimin e autorizimit;
- c) i autorizuari heq dorë me shkrim nga autorizimi.

Neni 44

#### **Publikimi i vendimit për autorizim**

1. Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë nxjerr dhe publikon buletin zyrtar metrologjik periodikisht.

2. Vendimi për autorizim, ndryshimi i autorizimit, mbarimi i vlefshmërisë dhe shfuqizimi i tij publikohen në buletin zyrtar metrologjik dhe në faqen zyrtare të DPM-së.

Neni 45

#### **Detyrimet e personit të autorizuar**

1. Personi juridik apo fizik, i autorizuar nga Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë, sipas pjesës IV të këtij kreu, duhet:

- a) të kryejë veprimtarinë e tij profesionalisht dhe në përputhje me rregullat e vendimet për autorizim;
- b) të njoftojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për mbarimin e autorizimit ose për ndonjë ndryshim të kushteve të autorizimit;
- c) të mbajë dokumentacion të formave të ndryshme për problemet administrative që lidhen me qëllimin e autorizimit, në përputhje me rregullat, nëse nuk përcaktohet ndryshe nga ky ligj, ose me rregullat e përshtatura për zbatimin e tij;
- ç) t'i paraqesë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë informacion të domosdoshëm, brenda afateve të caktuara dhe procedurave të përkrahura, për të dhënat e për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përcakton afatet dhe procedurat për dhënie të informacionit për instrumentet matëse të verifikuara.

KREU VI

### **INSPEKTIMI METROLOGJIK**

Neni 46

#### **Inspektimi metrologjik**

Inspektimi metrologjik kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë në përputhje me këtë ligj, si dhe me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Neni 47

#### **Detyrat e subjektit të inspektimit**

1. Personat juridikë apo fizikë, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i inspektimit, janë të detyruar ta ndihmojnë inspektorin dhe t'i japin atij të dhënat dhe informacionet e domosdoshme që lidhen me objektin e inspektimit.

2. Me kërkesë me shkrim të inspektorit, subjekti i inspektimit është i detyruar të japë ose të përgatisë, brenda një periudhe kohe të caktuar, të dhëna të plota dhe të sakta, informacione dhe regjistrime të nevojshme për kryerjen e inspektimit.

Neni 48

#### **Detyrat e inspektorit**

1. Gjatë inspektimit metrologjik, një inspektor kontrollon:

- a) përdorimin e njësive ligjore të matjeve;
- b) konformitetin dhe përdorimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara;
- c) konformitetin e parapaketimeve dhe të shisheve enë matëse me masat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij;
- ç) mënyrën se si mbahen dhe përdoren regjistrimet dhe dokumentet e përkrahura.

2. Në rastet kur kryerja e shërbimeve, objekt i këtij ligji, realizohet ekskluzivisht nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, inspektimi metrologjik përfshin vetëm ekzaminimin fizik dhe dokumentar të produkteve apo proceseve objekt të këtij ligji. Vetëm në raste përjashtimore dhe





gjithmonë me vendim gjykate, inspektimi metrologjik mund të përfshijë edhe ekzaminimin laboratorik për të realizuar kontrollin e përcaktuar në pikën 1 këtij neni.

3. Në rastet kur inspektori vëren shkelje të këtij ligji, të çdo kontrate dhe/ose instrumenti, i cili ka fuqinë zbatuese të ligjit dhe ka si objekt kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë ligj, dhe të rregulloreve të miratuara ose informohet për çdo shkelje të tij nga subjekte të autorizuar për të kryer veprimtari metrologjike në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, merr vendim aty për aty, por në çdo rast jo më vonë se 7 ditë nga konstatimi i shkeljes apo marrjes së informacionit nga subjektet e autorizuar prej ligjit dhe, sipas rastit, vendos një ose disa nga dënimet e mëposhtme:

a) dënim me gjobë, që vendoset për të gjitha shkeljet e konstatuara në përputhje me nenin 54 të këtij ligji;

b) pezullim të kryerjes së veprimtarive që janë në kundërshtim me këtë ligj ose me rregullat e nxjerra në zbatim të tij;

c) bllokim të instrumentit matës në rast moskonformiteti, përveç rasteve të kryerjes së verifikimit nëpërmjet inspektimit nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një format e parashikuara në legjislacionin në fuqi;

ç) urdhërim të korigjimit të parregullsive dhe mangësive të konstatuara brenda një periudhe kohe të specifikuar;

d) ndalimin e vendosjes në treg apo heqjen nga tregu të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, parapaketimeve dhe shisheve enë matëse.

Neni 49

#### **Informimi i subjektit të inspektuar**

Inspektori informon subjektin për kryerjen e inspektimit sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur një gjë e tillë cenon efektivitetin e inspektimit.

Neni 50

#### **Vendimi për ndalimin e vendosjes në treg apo heqjes nga tregu**

1. Kur konstatohet se instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, parapaketimet dhe shisheet si enë matëse, që do të vendosen në treg, janë jo në

konformitet me rregullat teknike, inspektori vendos ndalimin e hedhjes së tyre në treg.

2. Në rastin kur parapaketimet dhe shisheet si enë matëse në përdorim janë jo në konformitet me rregullat teknike, inspektori vendos tërheqjen e tyre nga tregu dhe kthimin te prodhuesi, paketuesi, importuesi ose përfaqësuesi i autorizuar.

3. Në rastin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim, të cilat konstatohen jo në konformitet me rregullat teknike, personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, ose inspektori vendosin bllokimin deri në kthimin e tyre në konformitet dhe njoftojnë organet e tjera kompetente shtetërore.

4. Kur parregullsitë e konstatuara dhe të dokumentuara në instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, parapaketimet dhe shisheet si enë matëse, që janë vendosur në treg ose në përdorim, nuk janë korigjuar brenda periudhës kohore të specifikuar, inspektori, krahas masave të tjera administrative, merr vendim për heqjen përfundimtare nga tregu të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, parapaketimeve dhe shisheve si enë matëse.

5. Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit për ndalimin e vendosjes apo heqjes nga tregu, kur konstatohet se instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, parapaketimet dhe shisheet si enë matëse, që do të vendosen në treg, janë jo në konformitet me rregullat teknike. Personat juridikë apo fizikë, pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

#### **KREU VII**

Neni 51

#### **Regjistri Elektronik i Metrologjisë dhe Kalibrimit**

1. Regjistri Elektronik i Metrologjisë dhe Kalibrimit përmban të dhëna për:



a) pajisjet matëse dhe kalibruese që janë në përdorim në Republikën e Shqipërisë, përfshirë gjurmueshmërinë në vazhdimësi të tyre;

b) subjektet që zotërojnë dhe përdorin pajisje matëse dhe kalibruese;

c) subjektet që janë të autorizuar sipas këtij ligji për të ushtruar veprimtari në zbatim të këtij ligji;

ç) subjektet që janë të autorizuar që të bëjnë riparime dhe mirëmbajtje të pajisjeve matëse dhe kalibruese;

d) rezultatet e inspektimeve të kryera në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. Regjistri krijohet dhe administrohet në bazë të legjislacionit për bazat e të dhënave shtetërore.

3. Rregullat e krijimit, administrimit dhe përdorimit të të dhënave të regjistrit, si dhe institucioni përgjegjës për administrimin e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### KREU VIII MASAT FINANCIARE

Neni 52

##### **Mënyrat e financimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë**

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë financohet nga buxheti i shtetit dhe administrimi i fondeve i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për institucionet buxhetore.

Neni 53

##### **Pagesat dhe tarifat e shërbimeve**

1. Kalibrimi, miratimi i tipit, verifikimi fillestar dhe pasardhës i instrumenteve matëse, miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve dhe të shisheve si enë matëse, shërbimet e metrologjisë ligjore të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, përfshirë edhe shërbime riparimi, si dhe trajnimet e ofruara kryhen kundrejt tarifave të miratuara nga autoritetet shtetërore përkatëse. Këto tarifa miratohen nga ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për ekonominë ose në një nga format e parashikuara në legjislacionin përkatës. Tarifat janë të njëjta si për subjektet vendase, ashtu edhe për ato të huaja, që ushtrojnë veprimtari prodhimi ose shërbimi në Republikën e Shqipërisë dhe për rastet e shërbimeve, objekt i këtij ligji, ato parapaguhet nga subjektet përkatëse. Mënyra dhe afatet e

parapagimit të këtyre tarifave përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i këtij ligji, si edhe laboratorët e etaloneve kombëtare, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për kryerjen e shërbimeve të ndryshme, përdorin tarifa të miratuara nga ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për ekonominë, ose të miratuara me një nga format e parashikuara në legjislacionin përkatës.

#### KREU IX KUNDËRVAJTJET DHE SANKSIONET

Neni 54

##### **Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet**

1. Kur inspektorët metrologë vërtetojnë se subjekti ka shkelur dispozitat e këtij ligji, nëpërmjet konstatimit të drejtpërdrejtë ose raportimit të personave juridikë privatë, të autorizuar në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të ofruar shërbime sipas këtij ligji, kanë të drejtë të vendosin gjobë sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, krahas dënimeve të tjera, të zbatueshme sipas këtij ligji, dhe të kërkojnë nga subjekti marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur afat për realizimin e ndreqjes.

2. Shkeljet e përcaktuara në pikat 2.1, 2.2 dhe 2.3 të këtij neni, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë dhe/ose dënime të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji, si më poshtë:

2.1 Për subjekte të biznesit të vogël 20 000 (njëzet mijë) lekë, për subjekte të biznesit të madh 100 000 (njëqind mijë) lekë, për stacione të tregtimit të karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse 200 000 (dyqind mijë) lekë, për shoqëritë që kryejnë veprimtari kërkimi e prodhimi, për rafineritë, impiantet e përpunimit të naftës-jellësit, për instalimet dhe terminalët bregdetare dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë 700 000 (shtatëqind mijë) lekë:

a) përdorimi i njësisve matëse në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 11 të këtij ligji;



b) mbajtja në biznesin e vet të një instrumenti matës që nuk është në përdorim dhe nuk është shënjuar në mënyrë të dukshme me shenjën “Instrument matës jo në përdorim”, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 19 të këtij ligji;

c) mbajtja në biznesin e vet të një instrumenti matës që nuk është në përdorim dhe është i shënjuar në mënyrë të dukshme me shenjën “instrument matës jo në përdorim”, për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i vendosjes së shenjës “instrument matës jo në përdorim”, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 19 të këtij ligji;

ç) moskryerja e verifikimit të instrumenteve matëse, sipas përcaktimeve të shkronjës “c” të nenit 20, mosmirëmbajtja e rregullt e instrumenteve matëse në kundërshtim me shkronjën “b” të nenit 20 dhe të pikës 2 të nenit 25 të këtij ligji;

d) mosvënia në dispozicion e instrumenteve matëse pas riparimit për verifikim, sipas përcaktimeve të nenit 28 të këtij ligji;

dh) mosplotësimi i kërkesave për regjistrim, të përcaktuara në pikën 3 të nenit 38 të këtij ligji;

e) mosdhënia e informacionit dhe e të dhënave të domosdoshme inspektorit për të kryer inspektimin, në kundërshtim me nenin 47 të këtij ligji;

2.2 Për subjektet e biznesit të vogël 20 000 (njëzet mijë) lekë dhe për subjektet e biznesit të madh 400 000 (katërqind mijë) lekë:

a) prodhimi, importimi dhe vendosja në treg e produkteve të paketuara dhe shisheve si enë matëse, që nuk plotësojnë kërkesat metrologjike dhe nuk kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshtuara sipas pikës 1 të nenit 37 të këtij ligji;

b) konstatimi i kushteve të shfuqizimit të vendimit të autorizimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, sikundër parashikohet në nenin 42, dhe mospërbushja e detyrimeve të subjektit të autorizuar sipas parashikimeve të nenit 45 të këtij ligji.

2.3 Për subjektet e biznesit të vogël 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për subjektet e biznesit të madh 300 000 (treqind mijë) lekë, për stacionet e tregtimit të karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, për shoqëritë që kryejnë veprimtari kërkimi e prodhimi, për rafineritë, impiantet e përpunimit të naftës jellësit, për instalimet dhe terminallet bregdetare dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë 5 000 000 (pesë milionë) lekë:

a) vendosja në treg dhe vënia në përdorim e instrumenteve matëse në kundërshtim me parashikimet e nenit 18, pikës 6 të nenit 25 dhe në rastet kur nuk zbatohet vendimi i inspektorit sipas pikës 1 të nenit 50 të këtij ligji;

b) përdorimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në kundërshtim me parashikimet e pikës 7 të nenit 25;

c) pengimi dhe/ose ndalimi i kryerjes së verifikimeve të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, sikundër parashikohet në pikën 4 të nenit 22 të këtij ligji;

ç) dëmtimi, heqja dhe/ose shkatërrimi i shenjës së verifikimit dhe vulave të sigurisë në instrumente.

3. Në rast përsëritje të së njëjtës shkelje, gjohet dyfishohen.

Neni 55

### Shqyrtimi dhe ankimi

Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të inspektorit bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionin në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 56

### Ekzekutimi

Gjohet ekzekutohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative. Të ardhurat e arkëtuara nga gjohet derdhen në buxhetin e shtetit.

KREU X

## DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 57

### Miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 2; 7, pika 2; 10, pika 2; 11, pika 2; 12, pika 5; 17, pika 5; 18, pika 6; 35, pika 3; 36, pika 3, dhe 51, pika 3, të tij.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për financat që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e



këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 53, pikat 1 e 2 të tij.

3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për ekonominë që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve, 19, pika 4; 20, shkronja “d”; 21, pika 5; 22, pika 6; 38, pika 4, dhe 39, pika 4, të tij.

4. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 27, pika 2, dhe 45, pika 2, të tij.

#### Neni 58

##### **Shfuqizimet**

1. Ligji nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, që nuk bien ndesh me dispozitat e këtij ligji, do të vazhdojnë të jenë në fuqi deri në daljen e akteve të reja nënligjore përkatëse, referuar këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

#### Neni 59

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.10.2020.